



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 15217 Prot

Shkodër, më 20.10.2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi "Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me "VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër".

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me "VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër".

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

Me Vendim Delegimi

Zv/Kryetar

Onid Bejleri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

“Për Miratim shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me “VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ; Udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2023” të ndryshuar, VKM 775 datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” i ndryshuar; Kontratës së Nëngrantit SG08601 me nr. ref.: Referenca: IPA/2022/432-813, Nr. 13739 Prot, datë 28.09.2023, në kuadër të thirrjes “Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri”, për projektin “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale” ndërmjet “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” –në rolin e Autoritetit Financues dhe Bashkisë Shkodër e cilësuar si nënëpunësues; “VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër" i ndryshuar. VKB nr. 12, datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”. Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër nr. _____, datë ____ / ____ / ____ ;

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin të miratuar me VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar për projektin "Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale", të detajuar si më poshtë: shtesë plani me burim financimi donacion me vlerë **6,404,700 Lekë**.

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian nën thirrjen Skema e Granteve "Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri", ku Autoriteti Financues përfaqësohet nga "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë".

Buxheti i Projektit i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 6,404,700 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Autoriteti Financues (donatori).

Buxheti i financuar nga Autoriteti Financues (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 6,404,700 lekë, për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.

2. Kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% me vlerë 230,000 dhe kosto të tjera në vlerën 70,000 lekë sipas nenit 14.4 të kontratës së grantit. Ky kontribut do të jetë pjesë e PBA – së 2024-2026.

3. Projekti do të zbatohet me llogari jashtë thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët" sipas tabelës së mëposhtme dhe fishës bashkëlidhur.

Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Transferime	Shpenzime kapitale
Shuma 2023	79,418	66,400	13,018			
Shuma 2024	6,272,230	544,990	91,010	3,922,980	1,601,170	112,080
Shuma 2025	53,052	45,460	7,592			
Shuma totale e Projektit e financuar nga Projekti	6,404,700	656,850	111,620	3,922,980	1,601,170	112,080
Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër	300,000			277,600		22,400
Totali	6,704,700	656,850	111,620	4,200,580	1,601,170	134,480

4. Miratimin e shtesës së numrit të punonjësve dhe miratimin e nivelit të pagës për punonjësit e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2023, 2024 dhe 2025.

Projekti ka parashikuar të punësojë një punonjës në rolin specialist - Koordinator Projekti sipas angazhimit: 1.5 muaj në vitin 2023, 12 muaj në vitin 2024 dhe 1 muaj në vitin 2025.

Fondi i përlogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori.

Niveli i pagës do të jetë sipas tabelës së mëposhtme;

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	1		IV-a	56,000		
Numri i Punonjësve	1					

Punonjësi do punojë me kohë të pjesshme me 60% të kohës për gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet Beci

Z/KRYETAR

Orid Bytyri

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse

Arbete Rexhepi

Drejtorja e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Carita Hoxha

Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Arliunde Krupa

Drejtorja Juridike

Dalila Lepa

Drejtorja e Financës

Matos Njoku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

RELACION

“Për Miratim Shtesë Plani Në Buxhetin E Vitit 2023 E Miratuar Me “VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për Miratimin E Buxhetit Të Vitit 2023 Dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 Të Bashkisë Shkodër, i Ndryshuar”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar Këshilltarë!

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ; Udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2023” të ndryshuar, VKM 775 datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” i ndryshuar; Kontratës së Nëngrantit SG08601 me nr. ref.: Referenca: IPA/2022/432-813, Nr. 13739 Prot, datë 28.09.2023, në kuadër të thirrjes “Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri”, për projektin “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale” ndërmjet “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” –në rolin e Autoritetit Financues dhe Bashkisë Shkodër e cilësuar si nënëpunësues; “VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër" i ndryshuar. VKB nr. 12, datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”.

Inclusive EduJobs “Drejt politikave dhe shërbimeve kontekstuale që rrisin punësimin dhe arritjet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri” është një projekt tre-vjeçar i zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).

Projekti synon gjithëpërfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri në fushën e punësimit dhe arsimit. Inclusive EduJobs ka tre shtylla kryesore: 1) Rritja e aksesit në tregun e punës; 2) Përmirësimin e arritjeve shkollore të nxënësve romë dhe egjiptianë; 3) Rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe organizatave.

Nëpërmjet projektit “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale” synojmë të reduktojmë hendekun socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian për të rritur pjesëmarrjen e tyre në komunitetin e Shkodrës.

Sfida e komunitetit rom dhe egjiptian ndaj tregut të punës është fakti se duke qenë të ptrajnuar dhe jo aq të arsimuar hasen me vështirësi të mëdha në punësim, duke e bërë hendekun social ekonomik më të madh se qytetarët e tjerë. Për këtë është shumë e rëndësishme që të bëhen hapa mbështetës në lidhje me punësimin e këtij komuniteti në mënyrë që të përfshihet në tregun e punës.

Një problem tjetër i rëndësishëm është niveli i ulët arsimor i fëmijëve dhe nëpërmjet projektit synojmë të rrisim numrin e nxënësve të komunitetit dhe të përmirësojmë performancën e tyre në studime. Edukimi i brezit të ri do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit të tyre ndaj arsimit dhe uljen e numrit të fëmijëve që nuk janë të arsimuar, gjenden në situatë rrugë ose kanë një mënyrë jetese të njëjtë me prindërit e tyre, pa një të ardhme konkrete të arsimuar, duke mbetur të marginalizuar nga shoqëria.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është:

Ulja e hendekut socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian drejt integritimit konkret në shoqërinë e qytetit.

1. Krijimi i mundësive për punësim dhe vetëpunësim;
2. Rritja e numrit dhe performancës së fëmijëve të regjistruar në shkolla.

Buxheti i Projektit:

Buxheti i financuar nga Autoriteti Financues (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 6,404,700 Lekë, për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.

Projekti do të zbatohet me llogari jashtë thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” sipas tabelës së mëposhtme dhe fishës bashkëlidhur.

Gjithashtu kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% dhe kosto të tjera në vlerën 300,000 lekë sipas nenit 14.4 të kontratës së grantit. Konkretisht e detajuar: mbulimi i vlerës së TVSH 20% me vlerë 230,000 dhe kosto të tjera në vlerën 70,000 lekë sipas nenit 14.4 të kontratës së grantit.

Ky kontribut do të jetë pjesë e PBA – së 2024-2026.

Vlerësojmë të rëndësishme të nënvizojmë që Bashkia Shkodër do të aplikojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rimbursimin e vlerës së TVSH.

Financimi do të bëhet në dy faza/këste: Kësti i parë me vlerë 30,000 Euro do të jetë paradhënie dhe ndërsa kësti i dytë me vlerë 30,000 Euro do të disbursohet nga donatori sipas nenit 4.1.c, pas dorëzimit dhe njohjes së shpenzimeve nga autoriteti financiar të kështit të parë.

Burimet Njerëzore:

Projekti ka parashikuar të punësojë një punonjës në rolin specialist - Koordinator Projekti sipas angazhimit: 1.5 muaj në vitin 2023, 12 muaj në vitin 2024 dhe 1 muaj në vitin 2025. Fondi i përlogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori.

Niveli i pagës do të jetë sipas tabelës së mëposhtme;

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	1		VI-a	56,000		
Numri i Punonjësve	1					

Punonjësi do punojë me kohë të pjesshme me 60% të kohës për gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Aktivitetet kryesore:

I: Puna në komunitet

Përmes këtij projekti duam të mundësojmë që kapacitetet e tyre të integrohen në programet e punës në komunitet në mbështetje të punëve që duhen bërë në qytet dhe nuk mbulohen nga buxheti i Bashkisë. Do të krijohet një “brigadë” punonjësish komunitar me detyrën specifike për të ndërhyrë në zonat e interesit të Bashkisë për të rritur cilësinë dhe performancën e shërbimeve publike veçanërisht në zonat turistike.

Skema e punës në komunitet do të hartohet në përputhje me VKM nr. 535 datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”, të ndryshuar. Gjatë zbatimit të projektit do të bëhet edhe blerja e pajisjeve për punët komunitare, prerëse bari, doreza, çizme, jelek, qese mbeturinash, lopata, fshesa, gershere etj, për të lehtësuar punën e tyre dhe për të krijuar kushtet që brigada të ketë një profesion të qëndrueshëm. edhe pas përfundimit të projektit.

II : Bursat

Ndihma dhe mbështetja me bursë për fëmijët dhe familjet e komunitetit rom dhe egjiptian do ta ndihmojë këtë grup të synuar në përfshirjen sociale nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm.

Nëpërmjet projektit propozohet që të ndihmohen edhe në materiale shkollore për nxënësit e arsimit të detyrueshëm dhe familjet e mbështetura, me blerjen e çantave, librave dhe aksesoreve shkollore për të lehtësuar dhe ulur shpenzimet e frekuentimit në shkollë. Për të marrë rezultate konkrete është planifikuar që të ketë një ekspert të jashtëm që do t'i ndjekë nxënësit në Qendrën Multifunkionale për 60 seanca për të kontrolluar dhe ndihmuar fëmijët në rritjen e performancës së tyre në shkollë.

Rezultatet:

Rezultati do të jetë fuqizimi social dhe ekonomik i 14 familjeve rome dhe egjiptiane që do të përfshihen në punët komunitare në territorin e Shkodrës sipas planit të planifikuar të Departamentit të Shërbimeve Publike.

Rezultati i dytë do të jetë rritja e frekuentimit të shkollave të 30 fëmijëve të komunitetit duke ulur kështu shkallën e analfabetizmit dhe duke rritur përfshirjen sociale dhe edukimin e fëmijëve në shkollë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Z/KRYETAR

Benet Beci



Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik

Arline Krapo

	Projekti: P10430.Q2.O1.A8. "Punësim dhe mësim për përfshirje sociale"	Funksioni 10: Mbrojtja Sociale N/Funksioni 104: Familja dhe Fëmijët Programi 10430: Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e Skemës së Granteve "Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri", ku Autoriteti Financues përfaqësohet nga "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", më 14.07.2023 me projektin " Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale". Projekti me nr. ref: IPA/2022/432-813 është përzgjedhur fitues për lidhjen e kontratës së grantit. e cila u nënshkrua më 28.09.2023 Buxheti i financuar nga Autoriteti Financues (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 60,000 Euro (6,404,700 Lekë), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.</p> <p>Projekti do të zbatohet me llogari jashtë thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët" sipas tabelës së mëposhtme dhe ffishës bashkëlidhur.</p> <p>Gjithashtu kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% dhe kosto të tjera në vlerën 300,000 lekë sipas nenit 14.4 të kontratës së grantit.</p> <p>Bashkëfinancimi me fondet e bashkisë për vlerën 300,000 lekë është për vitin 2024.</p> <p>Financimi do të bëhet në dy faza/këste: Kësti i parë me vlerë 30,000 Euro (3,202,350 lekë) do të jetë paradhënie dhe ndërsa kësti i dytë me vlerë 30,000 Euro (3,202,350 lekë) do të disbursohet nga donatori sipas nenit 4.1.c, pas dorëzimit dhe njohjes së shpenzimeve nga autoriteti financues të kësiti të parë.</p> <p>Ky fond është i detajuar në fishen totale të buxhetit të projektit në tabelën më poshtë.</p> <p>Për kohëzgjatjen e projektit është planifikuar me fondet e projektit punësimi i kordinatorit të projektit për vitet 2023, 2024 dhe 2025.</p> <p>Fondi i përlogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori.</p> <p>Koordinatori i Projektit do të punojë sipas angazhimit: 1.5 muaj në vitin 2023, 12 muaj në vitin 2024 dhe 1 muaj në vitin 2025.</p> <p>Punonjësi do punojë me kohë të pjesshme me 60% të kohës për gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.</p> <p>Nëpërmjet projektit "Puno dhe Mëso për Përfshirjen Sociale" synojmë të reduktojmë hendekun socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian për të rritur pjesëmarrjen e tyre në komunitetin e Shkodrës.</p>		
<p>Objektivi i përgjithshëm i projektit është:</p> <p>Ulja e hendekut socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian drejt integritit konkret në shoqërinë e qytetit.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Krijimi i mundësive për punësim dhe vetëpunësim; 2. Rritja e numrit dhe performancës së fëmijëve të regjistruar në shkolla. 		
<p>Aktivitetet Kryesore:</p>		
<p>I: Puna në komunitet</p> <p>Përmes këtij projekti duam të mundësojmë që kapacitetet e tyre të integrohen në programet e punës në komunitet në mbështetje të punëve që duhen bërë në qytet dhe nuk mbulohen nga buxheti i Bashkisë. Do të krijohet një "brigadë" prej 14 punonjësish komunitar me detyrën specifike për të ndërhyrë në zonat e interesit të Bashkisë për të rritur cilësinë dhe performancën e shërbimeve publike veçanërisht në zonat turistike.</p> <p>Skema e punës në komunitet do të hartohet në përputhje me VKM nr. 535 datë 8.7.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet", të ndryshuar. Gjatë zbatimit të projektit do të bëhet edhe blerja e pajisjeve për punët komunitare, prerëse bari, karafil, fshesa, lopata, thasë mbeturinash etj, për të lehtësuar punën e tyre dhe për të krijuar kushtet që brigada të ketë një profesion të qëndrueshëm. edhe pas përfundimit të projektit.</p>		
<p>II : Bursat</p>		
<p>Ndihma dhe mbështetja me bursë për fëmijët dhe familjet e komunitetit rom dhe egjiptian do ta ndihmojë këtë grup të synuar në përfshirjen sociale nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm.</p> <p>Nëpërmjet projektit propozohet që të ndihmohen edhe në materiale shkollore për nxënësit dhe familjet e mbështetura, me blerjen e çantave, librave dhe aksesoreve shkollorë për të lehtësuar dhe ulur shpenzimet e frekuentimit në shkollë. Për të marrë rezultate konkrete është planifikuar që të ketë një ekspert të jashtëm që do t'i ndjekë nxënësit në Qendrën Multifunkionale për 60 seanca për të kontrolluar dhe ndihmuar fëmijët në rritjen e performancës së tyre në shkollë.</p>		
<p>ii. Synimi i projektit</p>		
<p>Ulja e hendekut socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian drejt integritit konkret në shoqërinë e qytetit.</p>		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p>		
<p>I: Puna në komunitet;</p> <p>II: Bursat.</p>		
<p>b) Rezultatet që prisni</p>		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Fuqizimi social dhe ekonomik i 14 familjeve romë dhe egjiptiane. 2. Rritja e frekuentimit të shkollave të 30 fëmijëve të komunitetit. 		

c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
Komuniteti Bashkia Shoqëria Civile			Bashkia Komuniteti Projekti "Skema e Granteve "Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri"				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga për 1 punonjës (60% e kohës) (donatori)	79.4	66.4	13			
Shuma		79.4	66.4	13			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga për 1 punonjës (60% e kohës) (donatori)	636	545	91			
A.2	Blerje Karburant (Pa Tvsh),(donatori)	98			98		
A.3	Blerje Paisje pune per punetoret (doreza,çizme, jelek, qese mbeturinash, lopata, fshesa, gershere etj) (Pa Tvsh),(donatori)	185			185		
A.4	Blerje materiale shkollore për nxënësit (çanta, materiale didaktike, libra,kancelari etj), (Pa Tvsh), (donatori)	416			416		
A.5	Blerje prerëse bari (Pa Tvsh), (donatori)	112				112	
A.6	Blerje materiale zyre (kancelari) (Pa Tvsh), (donatori)	26			26		
A.7	Sherbim telefon per kordinatorin e projektit (Pa Tvsh), (donatori)	14			14		
A.8	Materiale promocionale (baner, fletepalosje, roll up, video ndërgjegjësuese etj) (Pa Tvsh), (donatori)	70			70		
A.9	Zhvillim aktiviteti (Pa Tvsh), (donatori)	47			47		
A.10	Zhvillim aktiviteti promovues per hapjen dhe mbylljen projektit (Pa Tvsh), (donatori)	53			53		
A.11	Mbikqyrësi/ eksperti i punës ne komunitet (Pa Tvsh), (donatori)	350			350		
A.12	Zhvillim aktiviteti për mbledhjen e familjeve dhe nxenesve të projektit (Pa Tvsh), (donatori)	128			128		
A.13	Tarifa e mentorit/asistentit, (donatori)	384			384		
A.14	Financimi fillestar i punës në komunitet (14 punëtorë të komunitetit R/E), (donator)	2,152			2,152		
A.15	Bursa per nxënësit e arsimit të detyrueshëm (donator)	1,601				1,601	
A.16	Projekti me nr. ref: IPA/2022/432-813, vlera e bashkëfinancimit me fondet e Bashkisë për TVSH –në (bashkia)	230			207.6	22.4	
A.17	Projekti me nr. ref: IPA/2022/432-813, vlera e bashkëfinancimit me fondet e Bashkisë për kosto të tjera (bashkia)	70			70		
Shuma		6,572	545	91	4,200.6	1,601	134.4
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operative	Transferi me	Kapitale
A.1	Paga për 1 punonjës (60% e kohës) (donatori)	53	45	8			
Shuma		53	45	8			
f) Periudha e zbatimit 2023,2024,2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Drejtorisë Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik; Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Institucioni Likujdues: Bashkia Shkodër					